

Si edhe infeksionet e tjera respiratore, infeksioni me 2019-nCoV mund të shkaktojë simptoma të moderuara si: **rrjedhje nga hunda, dhimbje në fyt, kollë dhe ethe.**

Tek disa persona mund të manifestohet një pasqyrë klinike më e rëndë, gjegjësisht të zhvillohet pneumoni ose vështirësi gjatë frymëmarrjes.

Sa është i rrezikshëm 2019-nCoV?



Po, 2019-nCoV shkakton sëmundje respiratore dhe mund të përcillet nga njeriu në njeri, zakonisht pas kontaktit të afërt me një person të sëmurë, për shembull në shtëpi, në vendin e punës, ose në institucion shëndetësor.

A mundet të përcillet 2019-nCoV nga njeriu në njeri?



**Институт за
јавно здравје**
на Република Северна Македонија

Personat të cilët jetojnë ose udhëtojnë në rajone ku qarkullon 2019-nCoV mund të jenë të ekspozuar ndaj rrezikut nga infeksioni.

Për momentin, 2019-nCoV qarkullon në Kinë ku edhe është regjistruar numri më i madh i të sëmurëve.

Personat e sëmurë të regjistruar në vende të tjera janë persona të cilët kanë bërë udhëtim në Kinë, ose kanë jetuar/bashkëpunuar me këta udhëtarë (p.sh. anëtarët e familjes së tyre, bashkëpunëtorët) ose punonjës shëndetësorë të cilët janë përkujdesur për pacientin para se të vërtetohet që ai ka qenë i infektuar me 2019-nCoV.

***Kush mund të
infektohet me 2019-
nCoV?***



Për të dhënë informacion të saktë në lidhje me atë se si ndikon 2019-nCoV tek njeriu duhet të bëhen hulumtime shtesë.

Sipas të dhënave në dispozicion, personat më të moshuar dhe personat me sëmundje ekzistuese paraprake (diabet, sëmundje të zemrës, etj.) janë më të rrezikuar nga zhvillimi i simptomave më të rënda.

Kush është i rrezikuar nga zhvillimi i simptomave më të rënda nga 2019-nCoV?



**Институт за
јавно здравје**
на Република Северна Македонија

Koronavirusi i ri është një virus respirator që fillimisht përcillet përmes kontaktit me personin e sëmurë, gjegjësisht përmes tajitjeve të tij respiratore që spërkatën në formë të pikave të imta kur personi i sëmurë kollitet dhe teshtin, përmes pështymës ose tajitjeve të hundës.

Është me shumë rëndësi që të gjithë të praktikojnë higjienë personale të mirë.

Për shembull, kur teshtini ose kolliteni, përdorni faculetë për një përdorim dhe hidheni atë menjëherë, ndërsa nëse nuk keni faculetë, mbulojeni hundën dhe gojën me mëngën e veshjeve.

Gjithashtu është me shumë rëndësi që të lahen duart me sapun dhe ujë, ose të pastrohen me preparate për dezinfektim që përmbajnë alkool.

Si përcillet 2019-nCoV?



Ende nuk dihet se sa gjatë mbijeton 2019-nCoV në sipërfaqe të ndryshme, edhe pse informacionet e para sugjerojnë se virusi mund të mbijetojë disa orë.

Virusin mund ta shkatërrojnë preparate të thjeshta për dezinfektim, me çka evitohet infektimi i mëtejshëm i njerëzve.

Sa gjatë mbijeton 2019-nCoV në sipërfaqe të gjësendeve të ndryshme?



**Институт за
јавно здравје**
на Република Северна Македонија

Sipas të dhënave në dispozicion, mendohet se është e mundur që personat e infektuar me 2019-nCoV të jenë infektiv edhe para se të zhvillojnë simptoma të sëmundjes.

Megjithatë, virusin zakonisht e përhapin persona të cilët kanë simptoma.

A mund të infektohemi me 2019-nCoV nga persona të cilët nuk kanë simptoma?